

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Unë, në fakt, për të respektuar agjendën dhe programin e Kuvendit dua të qëndroj fort pikërisht në pikën e rendit të ditës, sepse është e rëndësishme dhe lidhet me procesin e Integritimit Europian, së pari në respekt të procesit dhe së dyti, në respekt të qytetareve shqiptarë, të cilët presin nga ne, të zgjedhurit e tyre, për t'iu dhënë argumente, ose për t'iu bërë me dije, pra t'iu japim informacion çfarë ne miratojmë dhe çfarë ata përfitojnë nga këto vendime që kemi në Kuvend sot. Procesi i ri në të cilin jemi, anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian, përmban një sërë sfidash me qëllim përafrimin e rregullave, standardeve, politikave dhe praktikave të BE-së.

Presidentja Von der Lein, në seancën e djeshme të Parlamentit Europian, theksoi rëndësinë e anëtarësimit sa më shpejt të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me qëllim forcimin e demokracisë dhe lidhjen e vendeve të Europës, si garanci edhe për sigurinë dhe paqen në Europë, njëkohësisht dhe të atyre vendeve që janë sot anëtare të Bashkimit Europian, por që kanë pasur një sërë problemesh me demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjithashtu, zonja Lein e vuri theksin fort tek uniteti që duhet të kenë vendet e Bashkimit Europian dhe ato të cilat janë sot në rrugë e sipër. Dhe unë besoj se kjo shërben si një garanci jo vetëm për sigurinë, por njëkohësisht edhe për paqen në kontinentin e Europës.

Sulmet e fundit kibernetike jo vetëm në Shqipëri, por edhe në disa vende të tjera në Ballkan, dhe pasiguria që ofrohet në kontinentin tonë, theksojnë rëndësinë e një politike më strategjike që Bashkimi Europian duhet të ndjekë me vendet tona, ashtu si dhe vendet e tjera që kanë aplikuar për statusin e vendit kandidat, si: Ukraina, Gjeorgjia dhe Moldavia. Ridimensioni, që

BE-ja do të duhet t'i bëjë strategjisë së saj, është i rëndësishëm për të përballuar pasojat e një lufte për të gjithë kontinentin evropian për vitet e ardhshme. Për këtë arsye, mbështetja që BE-ja ka planifikuar të japë për Shqipërinë, për reformat dhe proceset në kuadër të integritit evropian do të shoqërohet edhe në mbështetje financiare edhe teknike, e cila është parashikuar në marrëveshjen kuadër financiare që kemi për miratim sot.

Kjo marrëveshje përcakton kuadrin ligjor, administrativ dhe teknik mbi bazën e së cilës do të financohen dhe zbatohen programet IPA 2021 - 2027. Ndryshe nga çfarë u tha këtu nga koleget e opozitës, unë mendoj se ngritja e një strukture të posacme SASPAC për menaxhimin, administrimin dhe koordinimin në mënyrë të konsoliduar, programet e financimit për të gjitha institucionet shtetërore, në kuadër të asistencës financiare të Bashkimit Evropian, do të ndihmojnë edhe në atë problematikë që e kemi diskutuar dhe që lidhet me përthithjen e fondeve dhe zbatimin e programeve të asistencës brenda afateve të parashikuara në marrëveshjet me BE-në. Ashtu si edhe ndarja e procesit teknik për procesin e integritit, që do të ndiqet nga ministrja e Shtetit për integrimin evropian, me procesin e menaxhimit të fondeve të BE-së, që ndiqet nga SASPAC-u, do të mundësojnë maksimizimin e rezultateve për të avancuar më shpejt në hapat e procesit drejt anëtarësimit.

Jo pa qëllim marrëveshja kuadër 2021 – 2027 fokusohet në prioritetet e procesit të zgjerimit sipas pesë pikave tematike, të cilat pasqyrojnë grupimet e kapitujve negociues sipas metodologjisë së rishikuar të zgjerimit për mbështetjen e zbatimit të reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike në linjë me vlerat e BE-së në përafrimin e legjislacionit dhe gradualisht të standardeve dhe praktikave të BE-së me qëllimin anëtarësimin në BE. Data 19 korrik shenoi një kapitull të ri edhe në kuadrin legjislativ, edhe në shtysën e reformimit të mëtejshëm, si edhe të hartimit të projektligjeve të reja. Qeveria shqiptare, nëpërmjet kësaj mbështetjeje të asistencës teknike dhe financiare të Komisionit Evropian, do të jetë më e përgatitur në përmbushjen e kriterëve dhe përafrimit të legjislacionit me BE-në.

Pavarësisht se vitet e fundit qeveria shqiptare dhe institucionet qendrore kanë bërë përgatitjet e tyre edhe në një proces paraprak të vlerësimit të legjislacionit dhe të të gjithë kuadrit

legjislativ apo siç quhet ndryshe procesi screening, i cili jam e bindur që do të ndihmojë patjetër në procesin e përsheptimit të parë në atë çka Bashkimi European së bashku me strukturat e tij do të monitorojnë për Shqipërinë. Fondet e IPA-s në këtë proces do të ndihmojnë në ndërtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe jo vetëm, të cilat do të sjellin progres dhe zhvillime pozitive jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin. Fondet e paranëtarësimit do ta ndihmojnë vendin tonë në arritjen e kushteve të vendosura nga Bashkimi European, duke përfshirë edhe qëndrueshmërinë ekonomike, por njëkohësisht edhe fusha të tjera siç janë transporti dhe energjia, si dhe një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm, fondet që jepen për programet e rinisë, të konsideruara si garancia rinore.

Marrëveshja e planifikuar në këtë dokument për programet IPA III do të jetë e fokusuar edhe te mbështetja për zbatimin e reformave për forcimin e shtetit ligjor, reformës në drejtësi, për vijueshmërinë e procesit të vetingut me mbështetjen që i jepet Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, për forcimin e rolit dhe të eficiencës së SPAK-ut në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve në mënyrë të integruar. Pra, janë një sërë procesesh, që vazhdojnë të mbështeten edhe në vitet në vijim sa i përket zbatimit të reformës në drejtësi. Meqenëse jemi te pjesa e drejtësisë, unë i dëgjova diskutimet që u bënë pak më parë, prandaj doja t'ju sillja disa shifra nga raporti i Gjykatës Europiane të Auditimit, një raport i vitit 2022, ku është bërë një vlerësim i të gjitha fondeve se si janë përthithur nga vendet e Ballkanit Perëndimor sa u përket programeve të shtetit të së drejtës.

Po të shohim tabelën që ata kanë nxjerrë në këtë raport, Shqipëria nuk është e fundit për përthithjen e fondeve të shtetit të së drejtës, por është e dyta me 134 milionë euro nga vitit 2014 deri në vitin 2022, renditet e dyta pas Serbisë. Patjetër, pse jo, ta kalojmë Serbinë qoftë në kapacitetet që duhet të ngremë, në institucionet, të cilat do të duhet të ngrihen, mbase edhe të koordinohen më mirë për të përthithur sa më shumë fonde, por më e rëndësishmja është që shifrat flasin vetë. Pra, në këtë fushë ne jemi të dytët në rajon. Për të mos folur që ka vende, të cilat i referohen një shifre prej 42 milionë të përthithura nga Bashkimi European, që do të thotë që ka një distancë dhe një diferencë shumë të madhe krahasimisht me atë që ne kemi mundësuar për të marrë fondet nga programet e Bashkimit European.

Në fakt, është shumë e rëndësishme për ta theksuar që ka një rëndësi edhe eficientia e fondeve që janë përthithur. U tha këtu disa herë nga kolegët e opozitës që nuk ka pasur eficienten e duhur, kështu që unë po ju sjell përsëri nga ky raport për shtetin e së drejtës, që Shqipëria është konsideruar, në krahasim me të gjitha vendet e rajonit, me një eficientë shumë të mirë në programin e shtetit të së drejtës, në strategjinë kundër korrupsionit, në procesin e vetingut, së bashku me OMN-në, në mbështetjen që i bëhet për formulimin dhe koordinimin e zbatimit të politikave antikorrupsion, ashtu edhe në mbështetjen e asistencës teknike që ne kemi pasur me Euralius IV. Njëkohësisht, më lejoni që me një tabelë tjetër, po prapë nga ky raport të tregoj eficienten dhe atë çfarë kemi arritur si progres pikërisht në këto 3 fusha.

Po i referohem raportit, ku janë të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Në luftën kundër korrupsionit dhe sistemit të drejtësisë, në reformën në drejtësi, Shqipëria krahasimisht me të gjithë vendet e tjera të rajonit për vitin 2019- 2020 nga ky vlerësim rezulton që ka pasur progresin më të lartë. Patjetër që ka ende shumë për të përmirësuar, sidomos në ngritjen e kapaciteteve, sidomos të atyre që do të duhen tashmë me këtë metodologji të re të përthithin fondet, të japin projekte që të jenë konkurruese, por, nga ana tjetër, do të duhet të kuptojmë që Shqipëria ka bërë maksimumin në çfarë i duhej të bënte sa i përket menaxhimit të fondeve të Bashkimit Europian.

Unë mendoj se me këtë marrëveshje, edhe me sugjerimet apo diskutimet që kemi pasur sot, ia vlen ta ritheksojmë që i gjithë uniteti ynë politik, pavarësisht ndasive që kemi nga përkatësitë e partive politike, duhet të na bashkojë tek agjenda europiane. Të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë dhe ta votojmë pro këtë marrëveshje. Faleminderit!